



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 6, datë 28.05.2025

I mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”, mbledhja e radhës për muajin Maj (Ora 10:10).

Marrin pjesë:

- | | |
|----------------------|-----------------------|
| 1. Brikena Sika | 19. Simo Petromilo |
| 2. Rajmonda Zoto | 20. Roland Strakosha |
| 3. Myzafer Elezi | 21. Ledja Shollaj |
| 4. Shkëlqim Leskaj | 22. Elca Bezhani |
| 5. Sokol Kushta | 23. Ilir Aliaj |
| 6. Edison Kapaj | 24. Vjola Xhafaj |
| 7. Simbol Pazaj | 25. Endri Hyseni |
| 8. Evis Allushi | 26. Englantina Imeraj |
| 9. Frosina Qyrdeti | 27. Ervis Moçka |
| 10. Liljana Breshani | 28. Brikena Puka |
| 11. Jerina Dervishaj | 29. Besmir Brahimi |
| 12. Klodian Xhyheri | 30. Alta Haluci |
| 13. Refie Laze | 31. Grigor Dede |
| 14. Lorel Canaj | 32. Eda Begaj |
| 15. Geron Gunbardhi | 33. Gëzim Çapoj |
| 16. Elpiniqi Mërkuri | 34. Anisa Ceno |
| 17. Arsen Belaj | 35. Edlira Kapllanaj |
| 18. Novrus Rrokaj | 36. Briseida Çakërri |

Mungojnë :

1. Vullnet Bilbilaj
2. Ardian Musta

- 3.Aurora Qarri
- 4.Eglantina Aliaj
- 5.Marsela Dashi
- 6.Gjergji Nika
- 7.Eneida Vera
- 8.Atird Hoxha
- 9.Anxhela Shenaj
- 10.Erëmal Arapi
- 11.Arjan Isufi
- 12.Dikens Bushaj
- 13.Liri Dëma
- 14.Bujar Osmënaj
- 15.Mujo Shakaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal
Nr 6/1, datë 28.05.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Përhëndetje!

E hapim mbledhjen sot, me dhënien e titullit “Qytetar Nderi i Vlorës”, Doc.Prof.Kristaq Kume .
Flet mbi jetën dhe veprën e tij.

Faleminderit dhe urime!

Përhëndet Kryetari i Bashkisë z.Ermal Dredha për figurën dhe gjurmët që ka lënë zoti Kume,
për kontributin e tij.

Urime dhe suksese!

Përhëndet dhe përfaqësuesi i Shoqatës “Labëria “z.Ahmet Dena.

Z.Ahmet Dena – Falënderoj Këshillin e Bashkisë që keni rënë dakort për dhënien e kësaj
dekorate.

Urime, Faleminderit!

Përhëndet zoti Myzafer Elezi në emër të Grupit të Djathtë të Këshillit të Bashkisë.

Përhëndet zoti Kristaq Kume. Falenderim për titullin e dhënë.

Mbyllet ceremonia e dhënies së titullit, Doc.Prof.Kristaq Kume.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Viojmë mbledhjen e këshillit.

Para se të fillojmë me shprehjen e ligjshmërisë , fajalën e ka Kryetari i Bashkisë për rendin e
ditës.

Z.Ermal Dredha – Përhëndetje dhe falënderim në lidhje me proçesin zgjedhor për të gjitha
forcat politike dhe të bëjmë më të mirën për Vlorën.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Faleminderit zoti Kryetar .

Viojmë me shprehjen e ligjshmërisë .(Lexon shkresën e ardhur nga Prefekti i Qarkut Vlorë)për
VKB Nr 27 – 37 , datë 29.04.2025 , vendimet kanë karakter individual dhe janë shprehur të
ligjshëm nga Prefekti i Qarkut Vlorë.

Faleminderit.

Vijojmë me Miratimin e procesverbalit , të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë datë 29.04.2025.

Pro – 32 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

2 këshilltarë pa votuar.

Miratohet.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Vijojmë me rendin e ditës, të cilit i është shtuar dhe një projektvendim nga administrata. I është dërguar dhe këshilltarëve.

Kalojmë në votim , rendin e ditës me këtë pikë shtesë.

Votohet

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal
Nr 6/2, datë 28.05.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 1 e rendit të ditës, projektvendimi ”Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin Prill 2025”.

Kalojmë në votim.

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal
Nr 6/3, datë 28.05.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 2 e rendit të ditës , projektvendimi”Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Prill 2025”.

Kalojmë në votim.

Pro – 33vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 6/4, datë 28.05.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 3 e rendit të ditës, Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën Janar – Prill 2025. Drejtori përkatës, të marrë fjalën.

Z.Kozma Mali – Administrata për hartimin e këtij projektvendimi, është bazuar në Ligjin Nr 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Neni 44, Neni 64/a..., Ligjin Nr 68/2017” ...,

Po japim një përmbledhje për 4-mujorin e parë.

Bashkia Vlorë për periudhën 2024 – 2025, është angazhuar për evidentimin dhe për problematikat që operojnë në Vlorë. Sipas rakordimit me Degën e Thesarit për 4-mujorin e parë . Plani i realizimit të të ardhurave 1.343.614 ose 58,2%.

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si prioritet ka likuidimet e prapambetura, uljen e shpenzimeve....

Nga të ardhurat, plan 238mijë....., realizuar në 62,7%;

Granti i pakushtëzuar, realizuar 304 ...mijë ose 55%

Granti specifik, realizuar në 42,6%

Nga buxheti i shtetit , realizuar në 34%.

Janë kryer pagesat sipas institucioneve për vitin ushtrimor 2025.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Diskutime nga këshilltarët.

Z.Klodian Xhyheri – Taksa e tokës bujqësore, është zero%.

Z.Kozma Mali – Në fund të vitit rakordojmë për këtë taksë.

Z.Klodian Xhyheri – Zënia e hapsirës për plazhet, 75%.

1% taksa e fjetjes në hotel.

Z.Kozma Mali – Në fund të 8-mujorit ky informacion.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pyetje apo diskutime të tjera?

Znj.Elca Bezhani – Në Komisionin e Ekonomisë , e diskutuam në prezencë dhe të disa drejtuesve të Bashkisë Vlorë. Në lidhje me taksën e tokës bujqësore , u tërhoq vëmendje dhe për administratorët e njësive për mbledhjen e kësaj takse.

-Taksa e fjetjes në hotel., nuk ka filluar vjelja e kësaj takse .

Pra, këtu është dhe puna e gjithë drejtorive të tjera.

Z.Besmir Brahimi – Tek rrugët, sinjalistika horizontale është problem shumë i madh në qytet.

-Mirëmbajtje trotuarësh që nuk ka.

Jam ankuar për trotuarët në Rrugën “Pelivan Leskaj “. S’kam parë një përgjigjës, të vijë ta kontrollojë atë .

Znj.Dorjana Ferhati- Jemi në dijeni të problematikave në qytet. Kompania po punon për mbulimin dhe shtrimin e kanaleve. Nga ne kontrollohen.

Sa të mbarojnë shtrimet e kanaleve, do vijmë dhe me sinjalistikën dhe, sidomos atë vertikale , por dhe i heqin qytetarët. Kemi çelur fondin për sinjalistikën.

Znj.Alta Haluci – Shpresojmë të mbyllen shpejt këto rrugë .

Në lidhje me varrezat publike, duhet pastruar dhe prerë bari. Rrugët duhen rregulluar.

Z.Besmir Brahimi – Dhe për kontenierët , tek Rajoni Nr 2, këto s’ekzistojnë fare.

5 kamionçina, shumë mirë që janë shtuar, dhe Policia bashkaikë të bëjë punën. Zonja, thotë, vidhen tabelat . Kush e mban përgjegjësinë ?

Për kontenierët që i lëvizin sipas dëshirës, kush e mban përgjegjësinë ?

Znj.Elpinqi Mërkuri – Nëqoftëse, s’keni diskutime të tjera , meqenëse s’ka për votim, është raport monitorimi, kalojmë në pikën tjetër.

Z.Ervis Moçka – Thjesht është analizë për 4 muaj, për punën e administratës së bashkisë.

Thjesht do të doja një strukturim për shifrat , jo se s’jam dakort me çfarë u tha.

Z.Geron Gunbardhi – Në Komisionin e Ekonomisë u diskutua dhe u theksua për taksën e tokës bujqësore, që është zero. Nga do marrim një përgjigje, si dhe me detyrat e lëna nga KLSH për tokat bujqësore e marra me qira.

Z.Ervis Moçka – Nëqoftëse, ka një drejtori përkatëse, në mbledhjen tjetër të na vijë pse s’është mbledhur kjo taksë, çfarë është bërë, problematikat ?

Meqenëse është shqetësim për të gjithë që, kjo taksë është zero, të lëmë një detyrë për njësitë të bëjnë një studim.

Në radhë të parë, njerëzit nuk janë.

Mënyrat si do mblidhen, dhe nëqoftëse, kërkojnë nga ne diçka për ti ndihmuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 6/5, datë 28.05.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 4 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e listës emërore të familjeve dhe individëve përfitues të projektit “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara “për vitin 2025.

Kush do ta marrë fjalën?

Znj.Drita Mustafai – Me këtë projektvendim, vjen lista me 25 familje që kanë aplikuar për këtë projekt.

Jemi bazuar në Ligjin Nr 22/2018, ...VKM 454/2019... për hartimin e këtij projektvendimi.

Në Dhjetor 2024 , qeveria kërkon nga bashkitë të aplikojnë për programet e strehimit.

Bashkia Vlorë ka aplikuar për këtë program, pasi ka banesa shumë të amortizuara. Të gjitha janë të sqaruara në relacion.

Bashkëlidhur projektvendimit kemi vendosur listën si dhe sqarimet e duhura , të ardhurat, numrin e familjeve etj..

Nga preventivat , vlera e preventivave të përbashkët është 23milion 454 mijë...

Z.Myzafer Elezi – Janë 25 familje me problematika të ndryshme.

A ka dhe familje të tjera për tu përfshirë dhe mendoj të ketë një stabilitet më të madh.

A ka familje të tjera, apo janë 25.

Znj.Drita Mustafai – Janë 6 projekte të strehimit. Është vendosur njoftim publik në faqen e bashkisë si dhe afishe në rajone dhe njësi . Ligji nuk ka afate. Aplikimet mund të vijnë .

Znj.Irena Toshkallari – Përsa i përket këtij grupi vunerabël , janë grupi i punës për të asistuar këtyre.

Znj.Rajmonda Zoto – Familjet në gabinetin e Plazhit të Vjetër ,përfitojnë nga ky projekt ?

Znj.Drita Mustafai – Kushti kryesor është që banesat të kenë në pronësi, ata janë futur për emergjencë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojnë në votim .

Pro – 34 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 6/6, datë 28.05.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 5 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e Deklaratës për Bashkëfinancim drejtuar Ministrisë së Ekonomisë , Kulturës dhe Inovacionit për “Programin e përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.

Është në varësi të pikës 4.

Znj.Drita Mustafai – Nga termat e referencës..., dhe lista kërkohet të kalojë në këshill bashkie.

Në termin e referencës, kufijtë financiarë , 40% nga bashkia dhe 60% nga qeveria.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim .

Pro – 34 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 6/7, datë 28.05.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 6 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e subvencionit të qirasë që përfitojnë familjet dhe individët e prekur nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës Transballkanike me Superstradën Fier – Vlorë”, sipas VKM Nr 254, datë 09.05.2018”.

Znj.Drita Mustafai – Në vitin 2015, janë prekur 31 familje. Në lidhje me këtë projektvendim kanë aplikuar 7 familje.

Me VKM Nr 254/2018, janë përcaktuar vlerat me subvencion, jo me qira të plotë.

50 me 50% ,Bashkia me EKB. Janë 7 familje, 1 u s’kualifikua për mungesë dokumentacioni.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Pro – 34 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 6/8, datë 28.05.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 7 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e familjeve dhe individëve që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast”.

Znj.Drita Mustafai – Është projektvendim që vjen disa herë në vit. Për shak të kushteve, kanë aplikuar për këtë projekt 44 familje, por Komisioni i Strehimit vendosi 34 familje për përfitimin e këtij subvencioni .

Afati i përfitimit është 1 vjeçar me buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Z.Illir Aliaj – Jam Kryetar i Komisionit të Strehimit , edhe pse ky komision nuk u mbledh, u përballa me një qytetar që ishte s’kualifikuar. Qytetari Ermir Qejvanaj, ishte me një fëmijë me aftësi ndryshe. Një nga pikat që s’përfitonte, ishte se banesa ku jetonte, ishte shumë lluksoze . Mendoj që kjo familje të përfshihet , s’ka mundësi ekonomike.

Znj.Drita Mustafai – Pjesë e procedurës është dhe, verifikimi në vend. Kemi shkuar në vend dhe kontrata ishte brenda familjes, ishte në kushte të mira.

Z.Myzafer Elezi- Nga konstatimi i zotit Ilir, a mund të na i thoni, a meriton familja të përfshihet?

Znj.Drita Mustafai – Fëmija ishte në karrocë , tetraplegjik. Kemi shkuar dy herë në banesë dhe verifikuam.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pse është s’kualifikuar ?

Znj.Drita Mustafai – Pala qiramarrëse dhe qiradhënëse, ishte brenda familjes.

Z.Illir Aliaj – Janë 34 familje, të shtohet dhe kjo familje dhe të kalojë në votim.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim me propozimin e zotit Ilir, për shtimin e familjes së z.Ermir Qejvanaj , pra nga 34, plus 1.

Votohet .

Pro – 34 vota

Kundër – 0 vota

Absetnim – 0 vota

Znj.Eda Begaj – Është dhë një zonjë që ka nevojë, znj.Razie me 3 fëmijë, 1 fëmijë të sëmurë..

Është i njëjti problem, është bërë publike. Është përfshirë në këto skema ?

Znj.Drita Mustafai – Personi nuk është paraqitur, nuk është i regjistruar.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pra, zonja le të paraqitet në bashki dhe, të ndihmohet .

Znj.Drita Mustafai – S’kemi numër kontakti.

Znj.Eda Begaj – Zonja Razie me 3 fëmijë, 1 fëmijë të sëmurë daun.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Është rasti publik që është bërë në faqet publike..Të paraqitet zonja pranë bashkisë dhe drejtoria përkatëse, ti ofrojë ndihmë.

Kalojmë në votimin e pikës 7., bashkë me shtesën e zotit Ilir Aliaj.

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 6/9, datë 28.05.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 8 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e privatizimit dhe të vlerës së privatizimit të banesave shtetërore të paprivatizuara”.

Znj.Drita Mustafai – Në këtë projektvendim, janë paraqitur kërkesa të 4 familjeve për privatizim banese., bazuar në VKM Nr 179/2020. Nga këto 3 banesa janë në Vlorë dhe 1 në Njësinë Administrative Shushicë. Këto familje posedojnë banesat , por nuk i kanë bërë privatizimet , në vitet 1993 deri në 1995.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal
Nr 6/10, datë 28.05.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën shtesë të rendit të ditës, në projektvendimin “Për miratimin e funksionimit të Qendrës së Zhvillimit PAK edhe si Qendër Komunitare ditore, si dhe një ndryshim në VKB Nr 111, datë 27.12.2024, “Për Buxhetin e Bashkisë, për vitin 2025”.

Znj.Elida Grabova – Ky është një projekt që konsiston që, krahas Qendrës Rezidenciale të shtohet dhe Qendra Ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara, kjo për 15 fëmijë si, dhe për 45 fëmijë të tjerë me orë të reduktuara.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Pro – 31 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal
Nr 6/11, datë 28.05.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën “Të ndryshme”.

Z.Illir Aliaj – Një shqetësim i banorëve, për heqjen e lavazhos tek shkallët e Varrezave të Dëshmorëve. Është poshtë pallatit, punon me orar pa orar.

Në rast se se zgjidhni dot, do ta zgjidh vetë.

Znj.Elca Bezhani – Mbledhjen e kaluar kam bërë një kërkesë, lidhur me sistemimin e kontenierëve, vendndodhjen e tyre.

Kemi kërkuar çfarë pune është bërë , për një hartëzim në lidhje me këto vendndodhje, për sistemimin e koshave që ndodhen pranë njësive akomoduese.

Pra, drejtoritë në bashkëpunim me njëra tjetrën të sjellin një projektvendim, ku të jetë bërë hartëzimi.

Z.Illir Aliaj – Në lidhje me diskutimin e zonjës Elca, tek Rruga e Re është një pikë, është e vetmja pikë në të majtë e cila është burim aksidentesh. Makina e mbetjeve e ka të vështirë të kalojë në atë krah. Ti kalojnë në anën e djathtë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Lidhur me vendndodhjen e koshave , ka shumë kërkesa dhe nga bizneset , dhe qytetarët...Problem vendodhja e tyre .

Znj.Irena Toshkallari – Është ngritur grupi i punës dhe po punon për këtë problematikë dhe së shpejti do ta sjellim në këshillin bashkiak.

Znj.Liljana Breshani – Jam shumë dakort në lidhje me shqetësimin për pikat e lavazhove., si dhe në lidhje me vendndodhjen e koshave dhe fashat e orareve të pastrimit.

Znj.Elpinqi Mërkuri – S’janë problem vetëm lavazhot, por dhe serviset.

Z.Sokol Kushta – Vlora turistike po rritet. Është rritur shumë numri i të ardhurve, i cili po bëhet shqetësim. Më parë punonin dhe ikin , tani jetojnë këtu.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Është problematikë e Policisë së Shtetit.

Z.Sokol Kushta – Prandaj thashë, të bashkëpunojnë. Rrugët janë shumë keq, por dhe trafiku shumë i rënduar.

Znj.Irena Toshkallari – Për personat endacakë ..Është fenomen shumë i theksuar. Kemi ngritur skuadrat e terrenit , këta nuk janë shtetas të Vlorës. Vijnë në kohën e turizmit . Kemi bashkëpunim , nuk ndërhyjmë dot ne, Policia e Shtetit.

Z.Arsen Belaj – Për pastrimin do diskutoja, sezoni turistik ka nisur.

-Pastrimi shumë problem në Orikum.

-Koshat zbrazen1 herë në 3 ditë. Nuk e di kush merret me këtë.

Ka punonjës në Ndërmarrjen e Shërbimeve, po nuk punohet në Orikum.

Të tërhiqet më shumë vëmendje Administratorit të Njesisë Orikum.

-Problem puna e energjisë

-Infrastruktura shumë keq, rrugët gropa gropa.

Duhet parë me më shumë përparësi Orikumi.

-Zyra e Shërbimit Social...Në Orikum, ka shumë familje që kanë nevojë për ndihmë, banesat shumë keq. Duhet sensibilizuar, të njoftohen këta banorë.

Z.Françesko Tozaj – Në lidhje me Orikumin, kemi ndryshuar koshat....Do bashkëpunojmë me administratorin e njesisë për një sezon sa më të mbarë.

Znj.Eda Begaj – Rritja e numrit të fëmijëve që lëvizin me skutera...Duhet një vëmendje nga Policia Bashkiake, ka shumë aksidente.

Të kontrollohen ata që i japin me qira, por dhe një përcaktim moshe.

-Shtimin e linjës së urbanit në Rrugën Transballkanike. Çfarë po bëhet .

Znj.Dorjana Ferhati – Aktualisht drejtoria jonë ka bërë një plan, jo vetëm për Vlorën, por edhe për njësitë. Po shtrohet si fillim në Nartë, dhe më vonë me radhë .

-Lidhur me transportin urban , po e diskutojmë me kryetarin dhe me operatorin e shërbimit publik, kështu që do vijmë me një propozim konkret.

Z.Arsen Belaj – Nuk kemi drita, jo ndriçim. S'kemi drita.

Z.Geron Gunbardhi – Bëra një kërkesë për koridoret ujore, kam marrë një përgjigje. Nuk kishte asnjë rezultat për koridorët ujore, nuk është zgjidhur, kështu që , dhe këtë sezon , nuk do ketë zgjidhje. Po shikohen procedurat. Plazhet , do ketë publikë dhe privatë. Po mbushet me çadrat.

Znj.Albana Ruci/ Përfaqësuese e Policisë bashkiake – Kam informacion për shqetësimin e zonjës Begaj dhe në bashkëpunim me drejtoritë në bashki, janë në monitorim këto subjekte që operojnë..Bashkëpunimi me ju dhe qytetarët ...Monitorimi i patrullave të policisë , është në vazhdimësi.

Znj.Evis Allushi – Do ngre dy shqetësime:

-Në zonën e pallateve, rreth shkollës “Marigo Posio”, në bodrumet e këtyre, janë jo vetëm ujra, por dhe mbeturina . Të merren masa emergjente .

Niveli i ujit dhe mbetjet, vërtet që është situatë shumë emergjente

-Banorët në lagjen “Llonxhë”, “Partizani”, janë ende pa ujë.

Znj.Irena Toshkallari – Për pjesën e ujit të pijshëm do ti drejtohem Ndërmarrjes së Ujësjellësit .

-Për shqetësimin e dytë, është hapsirë e përbashkët e pallateve. Do të bashkëpunohet ..

Z.Novrus Rrokaj – Për rrugën e Spitalit, banorët e kanë shqetësim.

Rrugët që janë hedhur dora e parë e asfaltit, përse nuk mbyllen ?

-Lidhur me kontenierët, vihen sipas qejfit. Mos ti lëvizin qytetarët sipas qejfit. Të vijë një material për këshillin e bashkisë.

Z.Françesko Tozaj – Do ta përgatisim.

Znj.Dorjana Ferhati – Lidhur me Rrugën “Ali Demi”, ka kaluar një material në këshillin e bashkisë, në lidhje me vendosjen e barierave.Aty kalon dhe ambulanca. Kjo rrugë kërkon një shpejtësi të caktuar. Është një projekt , do vendosen barierat dhe vijat e bardha.

-Përsa i përket rrugëve, po punohet.

Z.Daut Zëraj – Nëqoftëse, e keni bërë studimin e kontenierëve , duhet planifikuar bazamentët ,jo vetëm ata të rinjtë, por dhe ata ekzistuesit, të cilat janë në rrugë.

Z.Klodian Xhyheri – Tabelat me emrat e rrugëve ,...shumë prej tyre janë dëmtuar.

Znj.Dorjana Ferhati – Në lidhje me NSHP, i kemi evidentuar, po punojmë, por hiqen dhe nga qytetarët.

Do vijmë me një projektvendim të caktuar, të aplikojmë gjobat.

Z.Klodian Xhyheri – Shiheni murin e vjetër buzë rrugës . Do kemi humbje jete tek “Moli i Naftës”.

Z.Besmir Brahimi – Parkimet, nuk u kthye përgjigje. Kur do fillojnë.

350 parkime në total. Kur do fillojnë ?

Zoti Sekretar, kur të vijë kërkesa , kryesorja është, të marrim zgjidhje.

-Dua të shoh kontratën e Ndërmarrjes së Ujësjellësit.

Znj.Edlira Kapllanaj – Banorë të lagjes “Topana”, 4 familje pa ndriçim, tek rruga “ Faslli Zogaj”.

Uji i ftohtë, tek Shtëpia e Fëmijës, 60 familje pa ujë. S’janë përfshirë në projektin e Ujësjellësit.

Znj.Dorjana Ferhati – Po punojmë për një shpërndarje sa më të mirë në të gjithë qytetin.

Z.Novrus Rrokaj – Është një projekt që përfshihet i gjithë qyteti.

Znj.Dorjana Ferhati – Do kthejmë përgjigje .

Z.Novrus Rrokaj – Në lidhje me emërtimet e rrugëve , mos duhet të gjendet një mënyrë tjetër, të paktën rrugët kryesore.

Znj.Elpiniaq Mërkuri – Nëqoftëse s’keni gjë tjetër , faleminderit. Takohemi në mbledhjen e radhës.